



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

MURATIM DHE SUVATIM

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

B1-III-21

Tiranë 2021

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Rruga Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, kati i tretë, Tiranë Web site: www.akafp.gov.al

Tel/Fax. +355 42237087

Emërtimi i kualifikimit	Muratim dhe suvatim			Kodi B1-III-21
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin mësimor “Muratim dhe suvatim”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, të drejtimit mësimor “Ndërtim”, është zhvillimi i personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që e rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me muratimin dhe suvatimin në sektorin e ndërtimit.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Muratim dhe suvatim” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që: <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Ndërtim”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; - të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe punësimit:	Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin mësimor “Muratim dhe suvatim”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale të punonjësit të kualifikuar në këtë kualifikim profesional si dhe me Supplementin përkatës të nivelit e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në sipërmarrje ndërtimi shtetërore/private si murator, suvatues, patinues, etj. apo në njësi të shitjes së materialeve të ndërtimit, për t’u vetëpunësuar si individ i lirë ose mbas një përvoje pune të vetëpunësohet si sipërmarrës duke punësuar individë të tjerë në veprimtari të muraturës dhe suvatimit.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK (teknik/manaxher) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	B-II-01-11, B1-III-17			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënimit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin mësimor “Muratim dhe suvatim” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Vizatime ndërtimi

- Të interpretojë fletët e vizatimeve të ndërtimit si fletët arkitektonike dhe fletët konstruktive të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë 2kt;
- Të përshkruajë vizatime të planimetrisë së themeleve dhe prerjeve të tyre;
- Të përshkruajë vizatime të planimetrisë së kateve;
- Të përshkruajë vizatime të prerjeve;
- Të përshkruajë vizatime të pamjeve;
- Të përshkruajë vizatime të planit të strukturave të ndërkateve dhe shkallëve;
- Të përshkruajë vizatime të detajeve kryesore të ndërtesës;
- Të interpretojë skica me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje për të gjitha llojet e muraturave, me materiale të ndryshme;
- Të interpretojë detaje arkitektonike dhe konstruktive sipas përmasave të dhëna në fletët e vizatimeve;
- Të lexojë skicat dhe shenjat konvencionale të instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ftohje-ventilim, gaz etj.) të përdorura në një objekt të thjeshtë 2kt

Planifikim, organizim dhe parapërgatitje e vendit të punës në muratim dhe suvatim

- Të shpjegojë projektin e zbatimit për muratim dhe suvatim;
- Të shpjegojë hapat e nevojshme për muraturë dhe suvatim;
- Të përshkruajë mjetet dhe pajisjeve e nevojshme për procesin e punës dhe funksionimin e tyre;
- Të listojë llojet e materialeve të nevojshme për procesin e punës;
- Të shpjegojë nevojën për burime njerëzore për proceset e punës;
- Të shpjegojë kohën e nevojshme sipas kushteve teknike për proceset e punës;
- Të përshkruajë qëllimin e urdhrin të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e ndarjes së detyrave në ekip dhe të koordinimit me grupet e punës për procese të ndryshme në ndërtesë;
- Të përshkruajë hapat për parapërgatitjen e vendit të punës;
- Të shpjegojë llojet e matjeve dhe rëndësinë shënjitjeve gjatë punimeve të muratimit dhe suvatimit, sipas skicës;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndriçimit të duhur të vendit të punës;
- Të përshkruajë mënyrën e montimit dhe çmontimit të skelave të lëvizshme, nëse është e nevojshme;

- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit të vendit të punës.

Punime murature dhe termoizolimi të mureve

Mur tulle

- Të shpjegojë mënyrat e piketimit të mureve;
- Të shpjegojë mënyrat e kontrollit për vertikalitetin dhe horizontalitetin e mureve;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të përgatitjes të materialit lidhës, sipas recepturave të dhëna;
- Të përshkruajë teknikat e prerjes së tullës me mjetet përkatëse
- Të shpjegojë rëndësinë e ndërtimit të rreshtit të parë;
- Të shpjegojë mënyrën e lidhjes së mureve në struktura të ndryshme;
- Të shpjegojë mënyrën e lidhjes midis rreshtave;
- Të shpjegojë ndërtimin e qoshes dhe lidhjes “T”, “L” dhe (+) kryq;
- Të shpjegojë teknikën e ndërtimit të brezave dhe kolonetave beton-arme;
- Të shpjegojë teknikat e montimit të arkitrarëve në dyer dhe dritare;
- Të shpjegojë teknikat e shtrëngimit/lidhjes së murit në tavan;
- Të shpjegojë teknikat e përpunimit të fugave të llaçit;
- Të shpjegojë teknikat e vendosjes së materialit termoizolues dhe zëizolues në mure, sipas projektit;
- Të shpjegojë mënyrat e riparimeve të mundshme të mureve.
- Të përshkruajë hapat e ndërtimit të mureve të pusetave të rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit.

Mur guri

- Të shpjegojë akset dhe mënyrat e piketimit të mureve;
- Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të vertikalitetit dhe horizontalitetit të mureve;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të përgatitjes të materialit lidhës, sipas recepturave të dhëna;
- Të shpjegojë teknikën e ndërtimit të rreshtit të parë;
- Të shpjegojë mënyrat e lidhjes së mureve në struktura të ndryshme;
- Të shpjegojë teknikat e përpunimit të gurit para vendosjes në mur;
- Të përshkruaj teknikat e prerjes së gurit me mjetet përkatëse;
- Të shpjegojë ndërtimin e qoshes dhe lidhjes “T”, “L” dhe (+) kryq;
- Të shpjegojë sigurimin e lidhjes midis rreshtave dhe gurëve;
- Të shpjegojë teknikën e ndërtimit të brezave beton-arme dhe kolona prej guri;
- Të shpjegojë teknikën e ndërtimit të qemerit në dyer dhe dritare;
- Të shpjegojë rëndësinë e përpunimit dhe pastrimit e fugave të llaçit në kohën e duhur.

Mur dekorativ

- Të shpjegojë mënyrat e piketimit të mureve dekorative;
- Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së tullave dekorative dhe aksesoret përkatës të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të përgatitjes të materialit lidhës/stukues;

- Të shpjegojë teknikën e vendosjes së aksesorëve, montimin e tyre dhe ndërtimin e rreshtit të parë të murit dekorativ;
- Të shpjegojë mënyrën e ndërtimit të qoshes në lidhjen “T”, “L” dhe (+) kryq;
- Të shpjegojë ndërtimin e këndit të drejta, vertikalitetin dhe horizontalitetin e mureve;
- Të shpjegojë mënyrat e lidhjes së murit në struktura të ndryshme;
- Të shpjegojë teknikat e lidhjeve midis rreshtave sipas udhëzuesve dhe aksesorëve;
- Të shpjegojë teknikat e ndërtimit të qemerëve me tulla dekorative;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e pastrimit/përpunimit të fugave të mureve dekorativë në kohën e duhur;
- Të shpjegojë teknikat e instalimit të aksesorëve të ndryshëm, sipas projektit;
- Të shpjegojë kryerjen e riparimeve të mundshme të mureve dekorative.

Punime suvatimi dhe termoizolimi të mureve

- Të shpjegojë mënyrat e kontrollit për vertikalitetin dhe horizontalitetin e mureve para dhe pas suvatimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e lagies dhe pastrimit të murit para suvatimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të përgatitjes së sprucos, sipas recepturave të dhëna;
- Të shpjegojë mënyrat e sprucimit mbi sipërfaqet e mureve me krahë dhe/ose makineri;
- Të shpjegojë mënyrën e vendosjes së këndoreve dhe aksesorëve në këndet e mureve;
- Të shpjegojë mënyrën e vendosjes e rrjetës dhe lidhjen në mure me materiale të ndryshme;
- Të shpjegojë mënyrën e vendosjes së takove dhe nivelimin e fashave drejtuese;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së llaçit të përzier;
- Të shpjegojë mënyrën e mbushjes me llaç mes fashave;
- Të shpjegojë mënyrën e rrafshimit të shtresës mbushëse me llaç, të suvatimit ;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së finos sipas recepturave përkatëse;
- Të shpjegojë shtrirjen/aplikimin e finos mbi shtresën mbushëse të suvasë;
- Të shpjegojë trajtimin e shtresës së finos me përdaf e spërkatje, gërvishtje, çukitje etj.;
- Të shpjegojë mënyrën e suvatimit të shpatullave në paturat e dymve dhe dritareve;
- Të shpjegojë mënyrat e suvatimit të sipërfaqeve të termoizoluara me polisterol, lesh guri, etj.;
- Të përshkruajë hapat e suvatimit në sipërfaqen e tavaneve;
- Të përshkruajë hapat e suvatimit në sipërfaqen e mureve të jashtme;
- Të përshkruajë llojet dhe hapat e suvatimit dekorativ në sipërfaqe të brendshme e të jashtme, sipas materialit dhe teknikës së përdorur;
- Të përshkruajë llojet dhe hapat e patinimit të sipërfaqeve të mureve e tavaneve të brendshme e të jashtme, sipas materialit dhe teknikës së përdorur;
- Të përshkruajë llojet dhe hapat e termoizolimit të mureve, sipas materialit dhe teknikës së përdorur;
- Të shpjegojë mënyrat e kryerjes së riparimeve të suvatimeve.

Konstruksione mbajtëse

- Të listojë llojet e konstruksioneve mbajtëse të ndërtesave sipas skemave konstruktive;
- Të përshkruajë parimet bazë për konstruimin e elementëve prej betoni të armuar që punojnë në përkulje ose në shtypje si dhe themeleve dhe shkallëve;
- Të përshkruajë llojet dhe mënyrën e realizimit të konstruksioneve të thjeshta prej betoni të armuar të parapërgatitura dhe gjysmë të parapërgatitura;
- Të përshkruajë llojet e konstruksioneve mbajtëse prej guri e tulle, si dhe prej druri e metali.

Materialet

- Të përshkruajë llojet e gurëve dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë llojet e tullave dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë llojet e materialeve përbërëse të llaçit për suvatime;
- Të shpjegojë recepturat e materialeve përbërëse të llaçit për suvatime sipas markës së dhënë;
- Të përshkruajë llojet e materialeve lidhëse për mure guri, tulle etj.;
- Të shpjegojë recepturat e materialeve përbërëse të llaçit për muraturë sipas përdorimeve të tyre në punimet e muraturës;
- Të përshkruajë llojet e materialeve të termoizolimit në punimet e muraturës;
- Të përshkruajë llojet e materialeve ndihmëse për realizimin e punimeve të suvatimit (rrjeta përforcimi, këndore metalike, pikore, etj.).
- Të përshkruajë llojet e aksesorëve të nevojshëm në muratim dhe suvatim sipas përdorimeve të tyre;

Mjetet, instrumentet dhe makineritë

- Të përshkruajë llojet dhe përdorimin e mjeteve të punës, instrumentet matëse-niveluese në punimet e muraturës
- Të përshkruajë pajisjet dhe makineritë për teknikat e punimeve të muraturës;
- Të përshkruajë llojet e instrumenteve të piketimit dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë llojet dhe përdorimin e mjetet të punës dhe makineritë për teknikat e punimeve të suvatimit të mureve e tavaneve;
- Të përshkruajë llojet dhe përdorimin e mjetet të punës për teknikat e punimeve të patinimit;
- Të përshkruajë llojet dhe përdorimin e mjetet të punës për teknikat e punimeve të termoizolimit të mureve;
- Të përshkruajë llojet e makinerive për punime suvatimi dhe përdorimin e tyre (pompa elektrike, pompa mekanike, etj.);
- Të përshkruajë mënyrën e sistemimit të mjeteve të punës, instrumenteve matëse-niveluese dhe makinerive në vendin e punës;
- Të përshkruajë teknikat e mirëmbajtjes së mjeteve dhe makinerive të punës sipas manualeve të përdorimit;
- Të përshkruajë teknikat e pastrimit të mjeteve dhe makinerive të punës;

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë planin e sigurisë dhe vendosjen e tabelave të sigurimit teknike në objekt;
- Të shpjegojë standardin kombëtar dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Të shpjegojë manualët e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të interpretojë sinjalistikën në mjediset e punës;
- Të përshkruajë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
- Të interpretojë rregulloren përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- Të interpretojë rregulloren përkatëse për sigurinë e ruajtjes dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së higjienës personale në punë;
- Të shpjegojë rregullat e grumbullimit, ndarjes sipas llojit dhe largimit të mbetjeve nga vendi i punës;
- Të shpjegojë zbatimin e rregullave të shpëtimit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës para, gjatë dhe pas punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e raportimit të personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes dhe magazinimit të materialeve në përputhje me udhëzimet përkatëse në mënyrë që të mos rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të shpjegojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të shpjegojë rëndësinë e rrethimit të objektit dhe tabelat e sigurisë teknike;
- Të përshkruajë protokollet e duhura në raste pandemie.

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të shpjegojë sipërmarrjen me të gjithë elementet kryesore të saj;
- Të shpjegojë ndikimin e sipërmarrjes në biznes;
- Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të shpjegojë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes;
- Të shpjegojë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre;
- Të përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit;
- Të ojë rolin e TIK në komunikimin global (reklama, shitje, blerje, etj.);
- Të përshkruajë legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën e ndërtimit;
- Të shpjegojë planet ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët;
- Të përshkruajë përgatitjen e raporteve periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të shpjegojë hapat për vendosjen e çmimit përfundimtar për shërbimet e ofruara;
- Të shpjegojë mënyrën e plotësimit të procesverbalit të dorëzimit të punimeve;
- Të rendisë format dhe mënyrat e përpilimit, si dhe të arkivimit të dokumentacioneve;

- Të argumentojë kontrollin e çmimit të tregut të materialeve e pajisjeve sipas standardit të ndërtimit;
- Të përshkruajë llogaritjet e kostos së materialeve dhe çmimet e një shërbimi të kryer;
- Të rendisë mënyrat e përgatitjes së një oferte për punimet/shërbimin që do të kryejë;
- Të shpjegojë mënyrat e blerjes së materialeve dhe pajisjeve të ndryshme;
- Të interpretojë zbatimin e teknikave të marketingut për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të nënvizojë metodat e zhvillimit të karrierës;
- Të përshkruajë rëndësinë e përditësimit të njohurive për aplikimin e teknikave të reja në punë;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të rendisë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të nënvizojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të nënvizojë rëndësinë e marrëdhënieve me bashkëpunëtorët dhe rolin i tyre në veprimtarinë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve duke përdorur teknikat e duhura të komunikimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes me bashkëpunëtorët;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e punës në grup në punë;
- Të shpjegojë rregullat dhe domosdoshmërinë e koordinimit të veprimtarive me kolegët dhe vartësit;
- Të përshkruajë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;

Rezultatet e të nxënit në:

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin mësimor “Muratim dhe suvatim” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KE, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Vizatime ndërtimi

- Të vizatojë fletët arkitektonike dhe fletët konstruktive të projekt-zbatimit të një objekti të thjeshtë 2kt;
- Të zbërthejë vizatimet e planimetrive të themeleve dhe prerjeve të tyre;
- Të zbërthejë vizatimet e planimetrive të kateve;

- Të zbërthejë vizatime të prerjeve të objektit;
- Të zbërthejë vizatimet të pamjeve të objektit;
- Të zbërthejë vizatimet e planit të strukturave të ndërkateve dhe shkallëve;
- Të vizatojë detajet kryesore të ndërtesës;
- Të zbatojë skica me përmasa të dhëna në planimetri dhe prerje për të gjitha llojet e muraturave, me materiale të ndryshme;
- Të zbatojë detaje arkitektonike dhe konstruktive sipas përmasave të dhëna në fletët e vizatimeve;
- Të dallojë skicat dhe shenjat konvencionale të instalimeve (elektrike, furnizim me ujë, kanalizim, ngrohje-ftohje-ventilim, gaz etj.) të përdorura në një objekt të thjeshtë

Planifikim, organizim dhe parapërgatitje e vendit të punës në muratim dhe suvatim

- Të zbatojë projektin për muratim dhe suvatim;
- Të përcaktojë hapat e nevojshme për muraturë dhe suvatim;
- Të identifikojë mjetet dhe pajisjeve e nevojshme për procesin e punës dhe funksionimin e tyre;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve të nevojshme për procesin e punës;
- Të përcaktojë nevojën për burime njerëzore për proceset e punës;
- Të respektojë kohën e nevojshme sipas kushteve teknike për proceset e punës;
- Të zbatojë urdhrin e punës;
- Të organizojë ndarjen e detyrave në ekip dhe koordinimin me grupet e punës për procese të ndryshme në ndërtesë;
- Të zbatojë hapat për parapërgatitjen e vendit të punës;
- Të kryejë matjet dhe shënjimet e duhura gjatë punimeve të muratimit dhe suvatimit, sipas skicës;
- Të përdorë manualët e mjeteve të punës;
- Të përcaktojë ndriçimin e duhur të vendit të punës;
- Të montojë/çmontojë skelat e lëvizshme, nëse është e nevojshme;
- Të kryejë pastrimin e vendit të punës.

Punime murature dhe termoizolimi të mureve

Mur tulle

- Të kryejë piketimin e mureve;
- Të kontrollojë vertikalishtet dhe horizontalitetin e mureve;
- Të kontrollojë përgatitjen e materialit lidhës, sipas recepturave të dhëna;
- Të kryejë prerjen e tullës me mjetet përkatëse;
- Të zbatojë me saktësi ndërtimin e rreshtit të parë;
- Të zbatojë lidhjen e mureve në struktura të ndryshme;
- Të zbatojë lidhjen midis rreshtave;
- Të kryejë ndërtimin e qoshes dhe lidhjes “T”, “L” dhe (+) kryq;
- Të zbatojë teknikën e ndërtimit të brezave dhe kolonetave beton-arme;
- Të respektojë teknikat e montimit të arkitrarëve në dyer dhe dritare;
- Të kryejë shtrëngimin/lidhjen e murit në tavan;

- Të përcaktojnë teknikat e përpunimit të fugave të llaçit;
- Të respektojnë me përpikëri teknikat e vendosjes së materialit termoizolues dhe izolues në mure, sipas projektit;
- Të përcaktojnë mënyrat e riparimeve të mundshme të mureve.
- Të përcaktojnë hapat e ndërtimit të mureve të pusetave të rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit.

Mur guri

- Të përcaktojnë mënyrat e piktimit të mureve;
- Të kryejë kontrollin e vertikalitetit dhe horizontalitetit të mureve;
- Të kontrollojnë përgatitjen e materialit lidhës, sipas recepturave të dhëna;
- Të zbatojë me saktësi ndërtimin e rreshtit të parë;
- Të zbatojë lidhjen e mureve në struktura të ndryshme;
- Të zbatojë teknikat e përpunimit të gurit para vendosjes në mur;
- Të zbatojë teknikat e prerjes së gurit me mjetet përkatëse;
- Të kryejë ndërtimin e qoshes dhe lidhjes “T”, “L” dhe (+) kryq;
- Të sigurojnë lidhjen midis rreshtave dhe gurëve;
- Të respektojnë teknikën e ndërtimit të brezave beton-arme dhe kolonave prej guri;
- Të zbatojë teknikën e ndërtimit të qemerit në dyer dhe dritare;
- Të kryejë përpunimin dhe pastrimin e fugave të llaçit në kohën e duhur.

Mur dekorativ

- Të përcaktojnë mënyrat e piktimit të mureve dekorative;
- Të përzgjedhë me përpikëri tullat dekorative dhe aksesorët përkatës të tyre;
- Të kontrollojnë përgatitjen e materialit lidhës, /stukues;
- Të zbatojë teknikën e vendosjes së aksesorëve, montimin e tyre dhe ndërtimin e rreshtit të parë të murit dekorativ;
- Të kryejë ndërtimin e qoshes dhe lidhjes “T”, “L” dhe (+) kryq;
- Të kontrollojnë ndërtimin e këndit të drejtë, vertikalitetin dhe horizontalitetin e mureve;
- Të përcaktojnë mënyrën e lidhjes së mureve në struktura të ndryshme;
- Të sigurojnë lidhjen midis rreshtave sipas udhëzuesve dhe aksesorëve;
- Të respektojnë teknikat e ndërtimit të qemerëve me tulla dekorative;
- Të kryejë pastrimin/përpunimin e fugave të mureve dekorativë në kohën e duhur;
- Të zbatojë teknikat e instalimit të aksesorëve të ndryshëm, sipas projektit;
- Të kryejë riparimet e mundshme të mureve dekorative.

Punime suvatimi dhe termoizolimi të mureve

- Të kontrollojnë vertikalitetin dhe horizontalitetin e mureve para dhe pas suvatimit;
- Të kryejë procedurën e lagies dhe pastrimit të murit para suvatimit;
- Të kontrollojnë përgatitjen e sprucos, sipas recepturave të dhëna;
- Të kryejë sprucimin mbi sipërfaqet e mureve me krahë dhe/ose makineri;
- Të zbatojë vendosjen e këndoreve dhe aksesorëve në këndet e mureve;
- Të vendosë rrjetën dhe të kryejë lidhjen në mure me materiale të ndryshme;

- Të respektojë teknikën e vendosjes së takove dhe nivelimin e fashave drejtuese;
- Të përgatisë llaçin e përzier;
- Të realizojë mbushjen me llaç mes fashave;
- Të kryejë rrafshimin e shtresës mbushëse me llaç, të suvatimit;
- Të përgatisë finon;
- Të shtrijë/aplikojë finon mbi shtresën mbushëse të suvasë;
- Të trajtojë shtresën e finos me përdaf e spërkatje, gërvishtje, çukitje etj.;
- Të realizojë suvatimin e shpatullave në paturat e dyerve dhe dritareve;
- Të kryejë suvatimin e sipërfaqeve të termoizoluara me polisterol, lesh guri etj.;
- Të përzgjedhë llojet e suvatimit dekorativ në sipërfaqe të brendshme e të jashtme, sipas materialit dhe teknikës së përdorur;
- Të respektojë hapat e suvatimit në sipërfaqen e tavaneve;
- Të respektojë hapat e suvatimit në sipërfaqen e mureve të jashtme;
- Të përzgjedhë llojet e patinimit të sipërfaqeve të mureve e tavaneve të brendshme e të jashtme, sipas materialit dhe teknikës së përdorur;
- Të respektojë hapat e patinimit të sipërfaqeve të mureve e tavaneve të brendshme e të jashtme;
- Të përzgjedhë llojet e termoizolimit të mureve, sipas materialit dhe teknikës së përdorur;
- Të respektojë hapat e termoizolimit të mureve;
- Të kryejë riparimet e mundshme të suvatimeve.

Konstruksione mbajtëse

- Të identifikojë llojet e konstruksioneve mbajtëse të ndërtesave sipas skemave konstruktive;
- Të zbatojë parimet bazë për konstruimin e elementëve prej betoni të armuar që punojnë në përkulje ose në shtypje si dhe themeleve e shkallëve;
- Të dallojë llojet dhe mënyrat e realizimit të konstruksioneve të thjeshta prej betoni të armuar të parapërgatitura dhe gjysmë të parapërgatitura;
- Të identifikojë llojet konstruksioneve mbajtëse prej guri e tulle, si dhe prej druri e metali.

Materialet

- Të përzgjedhë llojet e gurëve sipas përdorimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e tullave sipas përdorimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve përbërëse të llaçit për suvatime;
- Të respektojë recepturat e materialeve përbërëse të llaçit për suvatime sipas markës së dhënë;
- Të marrë kampionet për provat laboratorike;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve lidhëse për mure guri, tulle etj.;
- Të respektojë recepturat e materialeve përbërëse të llaçit për muraturë sipas përdorimeve të tyre në punimet e muraturës;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve të termoizolimit në punimet e muraturës;

- Të përzgjedhë llojet e materialeve ndihmëse për realizimin e punimeve të suvatimit (rrjeta përforcimi, këndore metalike, pikore, etj.).
- Të përzgjedhë llojet e aksesorëve të nevojshëm në muratim dhe suvatim sipas përdorimeve të tyre;

Mjetet, instrumentet dhe makineritë

- Të përdorë mjetet e punës, instrumentet matëse-niveluese për punime të muraturës;
- Të përdorë pajisjet dhe makineritë e duhura për punime të muraturës;
- Të përzgjedhë llojet e instrumenteve të piketimit sipas përdorimit të tyre;
- Të përzgjedhë mjetet e punës, instrumentet matëse-niveluese dhe makineritë për teknikat e punimeve të suvatimit të mureve e tavaneve sipas përdorimit të tyre;
- Të përdorë mjetet e duhura të punës për punime të patinimit;
- Të përdorë mjetet përkatëse të punës për punime të termoizolimit të mureve;
- Të përzgjedhë makineritë për punime suvatimi sipas përdorimit të tyre (pompa elektrike, pompa mekanike, etj.);
- Të sistemojë mjetet e punës, instrumentet matëse-niveluese dhe makineritë në vendin e punës;
- Të mirëmbajë mjetet dhe makineritë e punës sipas manualeve të përdorimit.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të respektojë planin e sigurisë dhe vendosjen e tabelave të sigurimit teknike në objekt;
- Të respektojë standardin kombëtar dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Të zbatojë manualet e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
- Të respektojë sinjalistikën në mjediset e punës;
- Të zbatojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
- Të respektojë rregulloren përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- Të respektojë rregulloren përkatëse për sigurinë e ruajtjes dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të ruajë higjienën personale në punë;
- Të respektojë rregullat e grumbullimit, ndarjes sipas llojit dhe largimit të mbetjeve nga vendi i punës;
- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- Të kryejë pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës para, gjatë dhe pas pune;
- Të raportojë te personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të realizojë ruajtjen dhe magazinimin e materialeve në përputhje me udhëzimet përkatëse në mënyrë që të mos rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të zbatojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të kontrollojë vendosjen e tabelave të sigurisë teknike dhe rrethimin e objektit ku punohet;
- Të ndjekë protokollet e duhura në raste pandemie.

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të analizojë ndikimin e sipërmarrjes në biznes;
- Të përcaktojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të kuptojë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të bashkëpunojë me institucionet financiare për aktivitetin e biznesit;
- Të zbatojë legjislacionin dhe etikën në biznes;
- Të përdorë Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin global (reklama, shitje, blerje, etj.);
- Të zbatojë legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën e ndërtimit;
- Të përgatisë planet ditore, javore, mujore të punës në përputhje me detyrat;
- Të kryejë regjistrimin e të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët;
- Të përgatisë raportet periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Të zbatojë hapat për vendosjen e çmimit përfundimtar për shërbimet e ofruara;
- Të plotësojë procesverbalin e dorëzimit të punimeve sipas porosisë së klienti;
- Të përcaktojë format dhe mënyrat e përpilimit e arkivimit të dokumentacioneve;
- Të kontrollojë çmimin e tregut të materialeve e pajisjeve sipas standardit të ndërtimit;
- Të kryejë llogaritjet e kostos së materialeve dhe çmimet e një shërbimi të kryer;
- Të përgatisë një ofertë për punimet/shërbimin që do të kryejë;
- Të realizojë blerjen e materialeve dhe pajisjeve të ndryshme;
- Të zbatojë teknikat e marketingut për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të planifikojë hapat për karrierën bazuar në vendimmarrje;
- Të përditësojë njohuritë për aplikimin e teknikave të reja në punë;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të zbatojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të përdorë terminologjinë profesionale;
- Të bashkëpunojë me të tjerë në veprimtarinë e vet profesionale;
- Të zgjidhë ankesat dhe mosmarrëveshjet duke përdorur teknikat e duhura të komunikimit;
- Të vlerësojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes me bashkëpunëtorët;
- Të punojë në ekip duke zbatuar parimet e punës në grup;
- Të zbatojë rregullat dhe domosdoshmërinë e koordinimit të veprimtarive me kolegët dhe vartësit;
- Të respektojë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të bashkëpunojë duke respektuar parimet e punës në grup;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.